

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 119, datë 24.12.2024

PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË TRANSFERTAVE TË PAKUSHTËZUARA DHE SEKTORIALE SHITESË TË ALOKUARA NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR. 5, DATË 19.12.2024 “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.97/2023 “PËR BUXHETIN E VITIT 2024”, TË NDRYSHUAR

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr.84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” të ndryshuar, neni 8, pika 2, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.195, datë 22.12.2023 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Përdorimin e transfertave shtesë të alokuara në zbatim të Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024” të ndryshuar, sipas tabelës së mëposhtëme:

Programi buxhetor	Emërtimi projektit	Llog. Ekonomike	Fondi në mijë lekë
01110	Shlyerje e detyrimeve të prapambetura	602	93,287

04130	Ndërtim i markatës në Njësinë administrative Manëz, Bashkia Durrës	231	29,937
-------	--	-----	--------

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.


KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.12.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 768/prot.
8

Durrës, më 30.12.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.119 datë 24.12.2024 “Për miratimin e përdorimit të transfertave të pakushtëzuara dhe sektoriale shtesë të alokuara në zbatim të aktit normativ nr.5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

